



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM
Nr. 11 Datë 26.10.2020

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT Zj. MARJOLA RAMADAN SHUTI NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË LIBOHOVË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

VËREN

Me shkresën nr. 232 prot., datë 12.02.2020, këshilli i bashkisë Libohovë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për arsye të përfundimit të parakohshëm të mandatit zj. Arjana Safet Çomo.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe vendimit nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, Kreu II, pika 3, parashikon se: “Në rastet kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit për pozicionet dhe subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit, nuk përfshin detyrimin për depozitimin e një kërkesë formale nga subjekti, atëherë organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj.



Nr. 11 i vendimit

Data 26 .10.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit zj. Marjola Ramadan Shuti nga lista shumëmeërore për Këshillin e Bashkisë Libohovë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar rast pas rasti kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak Libohovë me numër rendor 02, z. Erjon Muharrem Sinani, 03, zj. Xhevrie Sedat Ismailati, 04, z. Karafil Filip Rustemi, 05, zj. Isrolda Feta Rustemi, 06, z. Arben Isuf Ruçi me kërkesë për plotësim dokumentacioni si kandidat vijues nga lista shumemërore e Partisë Bindja Demokratike, për Këshillin bashkiak Libohovë, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit. Këta kandidatë nuk kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor ka proceduar me kandidatin vijues të listës shumemërore të subjektit politik, Partia Bindja Demokratike, Bashkia Libohovë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit me numër rendor 07, zj. Marjola Ramadan Shuti.

Përpara plotësimit të vakancës në Këshillin e Bashkisë Libohovë, kandidati i listës shumemërore të Partisë Bindja Demokratike, zj. Marjola Ramadan Shuti, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve brenda 10 ditëve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Bindja Demokratike, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0040 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Marjola Ramadan Shuti, në këshillin e bashkisë Libohovë, rezulton se: Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitete e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga "Malo" në "Shuti".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 1646 prot., datë 15.10.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1645 prot., datë 15.10.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Marjola Ramadan Shuti, në Këshillin e Bashkisë Libohovë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 10524/1 prot., datë 21.10.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për



anëtar zj. Marjola Ramadan Shuti, në këshillin e bashkisë Libohovë, e cila rezulton me status e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Marjola Ramadan Shuti, në këshillin e bashkisë Libohovë, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Libohovë.

PËR KËTO ARSYE:


Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSA:

1. Zj. Marjola Ramadan Shuti, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Libohovë, të subjektit politik Partia Bindja Demokratike, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Libohovë, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore zj. Marjola Ramadan Shuti, të subjektit politik Partia Bindja Demokratike, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI



Nr. 11 i vendimit

Data 26.10.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit zj. Marjola Ramadan Shuti nga lista shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Libohovë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.